REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 520/22
23.11.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 520/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërjen nga Vedat Poterqoi- Kryetar, Kimete Gashi-Referuese, Agon Ramadani- Anëtar, , duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "Sodex Group" Prishtine, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma operacionale" me numër të prokurimit 214-21-9106-1-1-1, iniciuar nga Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 22.11.2022, mori:

VENDIM

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Sodex Group" SHPK, Prishtinë, e parashtruar me në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 06.10.2022, numër protokolli 520/2022, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma operacionale" me numër të prokurimit 214-21-9106-1-1-1, iniciuar nga Policia e Kosovës në cilësinë e AK, Kurse Njoftimi i AK (me të dhëna si në hyrje) i datës 27.09.2022, për anulimin e aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, Anulohet;

2. Urdhërohet AK që ta zbatoj Vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Nr. 217/22 dhe 224/22, i datës 00.00.2022, i cili konsiderohet çështje e gjykuar sipas nenit 105, paragrafi 1, nën-paragfrafi 2.16, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës;

3. Në afat prej 5 ditësh, AK (me të dhëna si më sipër) duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 dhe 25 paragrafi 9, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i amandamentuar);

3. Parashtruesi i Ankesës ka të drejtë që ushtroj kërkesë për kthimin e mjeteve në afat prej 60/ditësh nga dita e ptrabninmit të këtij Vendmi, konfom nenit 31 pararagrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP;

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 25.11.2021, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë të aktivitetit të prokurimit "Furnizim me uniforma operacionale" me numër të prokurimit 214-21-9106-1-1-1.
Me 25.01.2022, është bërë hapja e ofertave, kurse me 27.09.2022 AK ka publikuar Vendimin per anulimin e ketij aktiviteti te Prokurimit
Me 28.09.2022, OE"Sabit Makiqi B.I."ka ushtruar Kërkesë për rishqyrtim e Vendimit të cituar si më sipër të AK
Me 04. 10. 2022, AK ka marrë Vendim sipas të cilit është refuzuar kërkesa për rishqyrtim
Me 06.10.2022, OE ankues "Sodex" ka parashtruar ankesë (Nr.520/22), kundër Njoftimit mbi vendimin e datës 27.09.2022, të AK

- Vlerësimi paraprak dhe administrimi i provave –

Me rastin e vlerësimit paraprak, konstatohet se ankesa eshte ushtruar brenda afatit të parashikuar ligjor në pajtim me paragrafin 2, të nenit 109, sipas të cilit ankesa në OSHP dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. E njëjta po ashtu i plotëson kushtet, respektivisht prezumimet procedurale të parapara me paragrafin 1, të nenit 109, sipas të cilit, cituar: "Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së" *Dhe, cituar në vijim*: "Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji". Ankesës në rastin konkret po ashtu i kanë paraprirë veprimet e ndërmarra në kuptim të dispozitës së citiuar si më sipër dhe e njëjta po ashtu i plotëson elemenetet qenësore në kontekstin e nenit 111, përfshirë dhe dëshminë e pagesës së tarifës ankimore e parashikuar në nenin 118 të këtij Ligji. Në vijim, Paneli, konstatoi po ashtu se Parashtruesi i Ankesës është i pajisur me cilësitë e palës në ketë çështje administrative, ashtu sikurse është rregulluar me nën-paragrafin 1.11, të paragrafit 1, të nenit 4, të LPP. Prandaj në kontekstin e veprimeve përgatitore të ndërmarra si më sipër, konstatohet se ankesa bije nën jurisdiksionin e këtij Institucioni në kuptim të nenit 99, lidhur me nenin 104, të LPP dhe se procedurat vendimarrjes mund të zbatohen sikurse kërkohet me paragrafët 1 dhe 2, të nenit 116, të Ligjit të cituar.

Prandaj, bazuar në të lartëcekurat, Paneli Shqyrtues ka angazhuar në vijim ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit, i cili në pajtim nenin 113 lidhur me nenin 114, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (*në vijim:* LPP), është i autorizuar të bëjë një vlerësim preliminar të dosjes, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore, provat dhe veprimeve të ndërmarra nga palët. Me 18.10.2022, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e ekspertizës, i cili i përmban elementet e cituara si më sipër duke i ofruar njëherësh dhe rekomandimet si në vijim:

- Ankesa të aprovohet si e bazuar;
- Vendimi i AK i datë 27.09.2022, të anulohet, kurse Lënda të kthehet në rivlerësim;

Raporti i cituar si më sipër i ekspertit shqyrtues është pranuar nga palët, me ç'rast Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës së datës 24.10.2022, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues. Sidoqoftë, Paneli mori në analizë dhe shqyrtim të gjitha shkresat e kësaj lënde, me ç'rast pas administrimit të të gjitha provave të siguruara paraprakisht, analizimit dhe shqyrtimit të tyre krahas pretendimeve ankimore, raportit dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, përfshirë dhe deklarimet e palëve në seancës e shqyrtimit kryesor, konstaton se:

- Autoriteti Kontraktues për ketë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë kornizë , vlera e madhe, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimin më te ulët. Vlera e parashikuar e kontratës: 637,000.00 €.
- Aktet dhe veprimet e AK dhe të Ankuesit, janë ndërmarrë ashtu sikurse janë prezantuar si më sipër (*shih: Faktet dhe rrethanat procedurale*).

Mirëpo çështjet me natyrë kontestuese në rastin konkret konsistojnë kryesisht në faktin se, sipas pohimeve të ankuesit, i njëjti, është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit nga ana e AK, për shkaqet dhe arsyet të cilat identifikohen në vijim: Sipas AK, Ankuesi ka ofruar: a) çmime jo normalisht të larta për pozicionin "këmisha". Dhe, b) çmim jo normalisht të ulët për pozicionin "pantallona". Shakawet dhe/ose arsyet e cituara si më sipër vertetohen me aktin e AK: B42, Leter Standarde për OE të eliminiuar (Sodex), i datës 27.09.2022. Nga ky vështrim, Paneli konstaton se: *Vendimi i AK i datë 27.09.2022, është atakuar për shkelje të dispziitave me karakter material.* Përderisa veprimet e ndërmarra dhe rrjedha e procedurës, respektivisht aktivitetit të prokurimit, është në harmoni me parimet e përgjithshme të LPP (versioni i amandamentuar), pa nevojë që të cihen dispozita në ketë rast. Prandaj duke vazhduar më tej dhe nga ky aspekt, Paneli konstatoi se:

1. Përsa i përket konstatimit të AK lidhur me: a) çmime jo-normalisht të larta për pozicionin *këmisha*, mendimi ekspertit është si vijon: a) Ky pretendim ankimorë është trajtuar paraprakisht me Vendimin e OSHP, të datës 12.08.2022, Nr.217-224/22. Dhe se, b) sipas dispozitave ligjore të LPP, ky ligj nuk parashihen çmime "jo normalisht të larta" në procedurë të hapur, me përjashtim të rasteve të tejkalimit të buxhetit/vlerës së parashikuar nga AK. Në vijim, eksperti duke e karahasuar vlerën e parashikuar nga AK (pika 3 e raportit) në raport me çmimin e ofertës së ankuesit, ka konstatuar se në ketë rast çmimi i ofertës ankuesit është rreth 10% më i ulët se vlera e parashikuar. Më tej në Raportin e ekspertit shpjegohet se, gjatë analizimit të shkresave të lëndës, nuk ka dëshmi se AK ka bërë parashikimin e vlerës për pozicione konkrete, siç pretendon AK se për këmisha ka qenë vlera e parashikuar prej 190 €. Vlera e parashikuar e vetme e cila gjendet në shkresat e lëndës ka qenë 637,500,00 €, ndërsa oferta e ankuesit është me çmim dukshëm më të ulët se kjo vlerë, konkretisht çmimi i ofruar nga OE ankues është 573,600.00 €. Dhe për më tej: Sipas ekspertit shqyrtues çmimi i ofruar nga OE ankues në krahasim me vlerën e parashikuar nga vet AK nuk paraqet pengesë për realizimin e kontratës në pajtim me sasitë indikative të përcaktuara nga AK në dosje të tenderit.

2. Sa i përket arsyetimit të AK-së, se OE ankues ka ofruar çmim jo-normalisht të ulët për pozicionin 2 për *pantollona*, ku OE ka ofruar çmimin 164.80€, sqarojmë se pas analizimit të mëtutjeshëm, kemi gjetur se produkti/pantollonat e ofruar nga OE ankues sipas të dhënave në katalog quhen "Striker ULT Combat Pants" nga prodhuesi Slloven "UF Pro". Pas hulumtimeve të mëtutjeshme në internet kemi gjetur se ky produkt mund të gjendet me çmim të ulët deri 192.74 €. Dhe se, dallimi mes çmimit të ofruar nga OE ankues dhe çmimeve që kemi gjetur në treg është më

pak se 15%. Me gjithësi çmimi i OE ankues për këtë produkt është më i ulët se çmimi që kemi gjetur në dyqane online, nuk mund të themi se është çmimi "jo normalisht" i ulët. Në këtë rast, gjatë krahasimit të çmimeve dhe analizës së çmimeve të tregut, eksperti ka shpjeguar analizat e bëra duke theksuar se çmimet e publikuara në faqen dhe/ose rrjete elektronike (on-line) janë çmime të shitjeve me pakicë dhe meqë blerës janë individët, është e ditur se tregu i lirë, supozon fuqinë më e madhe blerëse dhe kjo reflektohet edhe në çmimit më të ulët të furnizimit. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart mendimi i ekspertit shqyrtues është se çmimi i ofruar nga OE ankues për pozicionin nr.2-pantollona nuk është çmim "jo normalisht" i ulët në krahasim me çmimin e tregut.

Është jo kontestuese se, faktet dhe provat e prezantuara si më sipër, kanë qenë objekt i shqyrtimit nga OSHP sipas Vendimit OSHP Nr.217-224/22, të datës 12.08.2022, megjithatë Paneli i analizoi të njëjtat sërish sipas bindjes së pavarur të tij dhe megjithatë konsideron se vendimi i AK për anulim bije në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP dhe rrjedhimisht me Vendimin e cituar si më sipër të OSHP. Pavarësisht pohimeve të ankuesit, Paneli mori në këtë rast në konsideratë analizat e Raportit të ekspertizës duke e vlerësuar të njëjtin si një dokuement profesional, i hartuar mbi bazën e analizave dhe provave bindëse të cilat e diktojnë vërtetë një zgjidhije të drejtë në ketë rast.

Paneli po ashtu vëren se, AK e ka publikuar Njoftimin për kontratë të aktivitetit të prokurimit që me datën 15.11.2021. Një rrjedhë e tillë e një procesi të prokurimit dhe kalimi i tij nëpër stadet tani më të njohura, atakon efiçiencën, efikasitetin, qëllimin për përmbushjen e nevojave të AK dhe bije ndesh me nenmin 1, të LPP, sipas të cilit qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, nenin 3, sipas të cilit ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar, lidhur me nenin 6, sipas të cilit, cituar: "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".

Paneli analizoi me kujdes në vazhdim, sërish nenin 62, Paneli konsideron se anulimi i këtij aktivitetit të prokurimit nuk është në harmoni me asnjë nga paragrafet përkatës të kësaj dispozite, sepse:

a) Në paragrafin 1, nënparagrafi 1.1, parashihet se AK duhet ta përfundoj një aktivitet të prokurimit nëse një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit gjë që në rastin konret nuk karakterizohet me një rrethanë të tillë.

b) Në paragrafin 2 (nën-paragrafët 2.1 dhe 2.2) parashihet se AK mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit nësë të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK, e që në ketë rast nuk paraqitet një fakt i tillë dhe

c) nëse para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues, gjë që as një fakt i tillë nuk ka ndodhur. Në ketë rast, veçohet mendimi i ekspertit se, (neni 4 i RRUOPP të cilit i referohet AK) nuk e rregullon çështjen përfundimit së një aktiviteti të prokurimit, pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave gjë që edhe ky mendim i ekspertit është i drejtë.

Pavarësisht të lartëcekurave, në nenin 105, paragrafi 2.16, parashihet se, cituar: "Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res

judicata". Në ketë rast, OSHP ka nxjerrë një vendim i cili përfshihet nën jurisdiksionin e kësaj disopizite dhe i njëjti përbën çështje të gjykuar, prandaj Paneli vendosi si si në piukën 2, të dispozitivit të këtij Vendimi. Mirëpo krahas kësaj e konsideroi të drejtë paragrafin pasues të këtij dispozitivit nëse eventualisht vendimi në rastin konkret nuk zbatohet nga AK. Krahas kësaj OSHP, i kujton AK se aktiviteti i prokurimit në rastin konkret ka të bejë me kontratën kornizë e cila si e tillë rregullohet dhe parashihet me nenin 38 të LPP dhe nenin 54, parfrafi 10 dhe 11, të Rregullores Nr. 001/2011 Për prkurimin publik.

Në kontektsin e arsyetimit të këtij Vendimni, se Paneli po ashtu mori vendim të lejohet kthimi i tarifës për ankesë për OE "Sodex" SHPK, sipas nenit 31, paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP, Nr.1/20, datë 03.03.2020.

- Përfundim –

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore. Mirëpo, Paneli shqyrtues konsideron se ndërmarrja e veprimeve për inicimin e prokurimit dhe me pas anulimi i të njëjtit pa asye dhe bazë ligjore bije ndesh me nocionet, parimet dhe institutet themelore të LPP. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Prandaj meqë faktet dhe rrethanata të cilat e orinetojnë një AK drejtë aplikimit të nenit 62, të LPP nuk janë paraqitur, Paneli konsideron se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP (versioni i amandamentuar) dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 44.6 dhe 44.7 të RRUOPP.

Prandaj bazuar në të lartëcekurat, Paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP, vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, mirëpo pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet me padi Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 Autoriteti kontraktues

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.